



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Prijmljenof/Prodato Received/Delivery	18.05.2022	viti god year	2
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtypja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHKESHCK	2896/2022		113



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

**A.nr.325/2022**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**--Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.325/2022 të datës 04.04.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë:

kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "*Kompensim material*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 17.05.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**Përfundon Procedimi Administrativ** i iniciuar me ankesën me numër A.nr.325/2022 e datës 04.04.2022 të parashtruar nga ankuesi

**A r s y e t i m**

Ankuesi sipas shkresave të lëndës i punësuar në Komunën e Prishtinës në pozitën "Inspektor i Ndërtimit", ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar më datë 04.04.2022 me numër të ankesës A.nr.325/2022 dhe nr. prot:1833/2022, kundër organit të Komunës së Prishtinës me pretendimin ankimor për kompensimin e 50% pagës për shkak të pezullimit si dhe korrigjimin e arsyetimit e vendimit të datës 27.10.2021 për kthimin në vendin e punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 08.04.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Komunën e Prishtinës. Më datë 21.04.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Prishtinës, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 04.04.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; kërkesën e ankuesit të datës 01.12.2021; Kërkesën e ankuesit të datës 14.02.2022; Kërkesën e ankuesit të datës 21.12.2021 drejtuar Drejtorisë për Financa pranë Komunës së Prishtinës; Aktgjykimin me numër APS.nr.4/2021 të Gjykatës së Apelit-Departamenti Special; Vendimin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës i datës 27.10.2021; Aktin e emërimit të datës 01.11.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 08.04.2021; Përgjigjen në kërkesë e datës 21.04.2022 me numër prot:2301/2022; Aktin përcjellës të datës 12.11.2021; Kërkesën e ankuesit të datës 05.07.2021 për kthim në vendin e punës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit është bërë i pamundur, *sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar ankesën e ankuesit dhe të gjitha provat e lëndës, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për objektin e njëjtë të ankesës të ankuesit, me datë 20.04.2022 ka nxjerr Vendimin me numër A.nr.262/2022, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht ankesën e ankuesit me numër A.nr.729/2021 të datës 09.08.2021, ankesë të cilën e kemi shqyrtuar sipas Aktgjykimin A.nr.2477/2021 të Gjykatës Themelore të Prishtinës-Departamenti për Çështje Administrative, kështu që Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ, respektivisht pretendimi ankimor për kompensimin e 50% të pagës për shkak të pezullimit nga marrëdhënia e punës si dhe korigjimi i arsyetimit të vendimit të datës 27.10.2021 për kthimin në vendin e punës, sipas ankesës së ankuesit të datës 04.04.2022 tashmë është vendosur me rastin e shqyrtimit të ankesës së ankuesit të datës 09.08.2021, andaj në pajtim me dispozitat e nenit 101 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike"*, Kolegji merr vendim që të përfundoj procedimin administrativ i iniciuar me ankesën e ankuesit të datës 04.04.2022 pasi që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për rastin e ankuesit ka vendosur paraprakisht.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.nr.325/2022

**Flakron GASHI**

  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

